

**Ejalor
Frazeologjik
Ballkanik**

**Ejalor
Frazeologjik
Ballkanik**



591,491
F5394

Ymeri Shani Prof.
(Slava)

Prof. Dr. Jani Thomai
Prof. Dr. Xhevat Lloshi, Dr. Rusana Hristova
Dr. Kosta Qiriazati, Ana Melonashi

FJALOR FRAZEOLOGJIK BALLKANIK

(me rreth 5000 njësi në pesë gjubë)

Shtëpia Botuese DITURIA

491.991
F5894

General Stevan Pap
(Stein)

PARATHËNIE

Siç dihet, që nga K. Sandfeldi e, më pas, P.Papahaghi, E.Çabej etj., është pohuar se ka një "bashkësi gjuhësore ballkanike", e krijuar në një trevë historikisht të lashtë të bashkëjetesës së popujve, pra, që i kanë shtuar afritë gjuhësore tipologjike edhe me ndikime të ndërsjella. Në frazeologji kjo afri është llogaritur deri në 400-500 njësi, por e vërteta është se e kalon dhjetëfishin. Faktorët jashtëgjuhësorë, si ata gjeo-historikë, psikologjikë, etno-kulturorë, mitologjikë etj., kanë luajtur një rol të veçantë në këtë drejtim. Anasjelltas, paralelet frazeologjike në gjuhët e Ballkanit, nga njëra anë, janë dëshmi e afrisë tipologjike gjuhësore, me gjithë dallimet e mëdha ndërmjet shqipes, greqishtes e gjuhëve sllave (përjashtuar turqishten); nga ana tjetër, dëshmojnë afritë që u krijuan në bashkëjetesën e gjatë historike, përputhjet në mendësinë e psikologjinë popullore, ngjashmëritë etno-kulturore etj.

Ballafaqimi i gjuhëve në frazeologji spikat edhe dallimet strukturore, që kushtëzohen nga veçoritë e sistemeve gjuhësore. Këto dukuri prekin, fjala vjen, gjuhët me trajtë të shquar të emrave, me paskajdre të foljeve, me përemra atonë etj. Kështu, krahasimi i njësive frazeologjike ndërmjet gjuhëve të Ballkanit hedh dritë mbi paralelet tipologjike, mbi ndikimet e ndërsjella dhe mbi interferencat nga gjuhë të tjera (si nga turqishtja e nga gjuhët neolatine). Pavarësisht nga burimet, "bashkësia gjuhësore ballkanike" në frazeologji shpreh më qartë origjinalitetin e gjuhëve dhe njëherazi thellësinë e ndikimeve ndërgjuhësore në kushte të ngjashme.

Duke hartuar një fjalor frazeologjik ballkanik, me një korpus të zgjedhur sipas teorisë frazeologjike bashkëkohore, zgjidhen edhe probleme të sinonimisë, të perifrazave të figurshme, të sintagmatikës dhe veçanërisht të semantikës e të vlerave konotative e funksionale të frazeologjisë. Një fjalor i tillë, veç vlerave praktike, ka vlera njohëse, vlera krahasuese dhe, pjesërisht, vlera standardizuese. Është e kuptueshme që, në aspektin teorik, kërkohet më parë qartësimi i disa problemeve themelore:

a. I pari është problemi *i identitetit të njësisë frazeologjike* në përgjithësi dhe për çdo gjuhë në veçanti. Specifikat e frazeologjisë dhe të sistemeve të gjuhëve të veçanta e bëjnë këtë një nga problemet më të vështira. Ballafaqimi me strukturat fqinje e lehtëson përvijimin e kufijve të njësisë frazeologjike dhe përcaktimin e identitetit të saj. Struktura sintagmatike, njësia kuptimore, barasvlera funksionale me fjalën, figurshmëria etj. janë disa nga tiparet më të përgjithshme të pranuar edhe në frazeografi. Gjuhët këtu dallohen nga elementet konstruktive e fakultative, nga variacioni gramatikor e leksikor etj.

b. *Modelimi në frazeologji*. Kjo lehtëson mjaft praktikën leksikografike, kurse teorikisht vërteton se frazeologjia është e organizuar në sistem, sido që i një lloji të veçantë, që lejon kodifikimin e saj ndër fjalorë.

c. *Barasvlerësia semantike* e njësive frazeologjike në një fjalor shumëgjuhësh, duke pasur parasysh edhe vlerat mbishtresore (funksionale, emocionuese, shprehëse e stilistike); këtu spikat gjithashtu veçoria e çdo gjuhe.

ç. *Burimi i lëndës dhe përzgjedhja* e saj (nga fjalorët, nga kartotekat, nga ligjërimi i folur dhe i shkruar, sidomos nga folklori e letërsia artistike).

1. Si çdo vepër leksikografike, edhe fjalori frazeologjik ballkanik përmban njësitë frazeologjike të shqipes dhe barasvlerësit e tyre të gjuhëve të tjera të Ballkanit, të përcaktuara dhe të trajtuara sipas një teorie frazeografike implicite. Zgjidhjet teorike për këtë fjalor janë formuluar në studime që i kanë paraprirë atij, të cilat sigurojnë sistematikën në makrostrukturën dhe në mikrostrukturën e fjalorit.

Fjalori frazeologjik ballkanik, mund të thuhet, është i pari në llojin e vet. Fjalorë frazeologjikë njëgjuhësh ka pothuajse për të gjitha gjuhët e Ballkanit. Ka edhe disa fjalorë frazeologjikë dygjuhësh për përdorim shkollor, por nuk ka asnjë fjalor frazeologjik shumëgjuhësh. Tipi i fjalorit dhe mungesa e përvojës i shtojnë problemet e vështirësitë, në nivel teorik e praktik. Ndërmarrja e këtij projekti zgjidh kështu teorikisht e praktikisht për herë të parë kërkesat e një vepre të tillë për gjuhët ballkanike.

“Bashkësia gjuhësore ballkanike”, e krijuar në një truall historikisht të lashtë të bashkëjetesës së disa popujve indoevropianë, pasqyrohet në frazeologji edhe me paralele frazeologjike të njëjta a të ngjashme ndërmjet gjuhëve. Sipas këtij realiteti historiko-social e gjuhësor dallohen katër shtresa paralelesh frazeologjike:

a. “Ballkanizmat” frazeologjikë, të krijuar historikisht nga bashkëjetesa brenda këtij trualli gjuhësor.

Këtu po shfrytëzojmë rastin për të shprehur mendimin për konceptin “ballkanizëm”. Së pari, thelbi i konceptit “ballkanizëm” nuk është aq numri i gjuhëve, në të cilat gjendet njësia a dukuria gjuhësore, por burimi dhe procesi i “ballkanizimit” të kësaj njësie a dukurie. Së dyti, natyra e konceptit “ballkanizëm” nuk është e njëllotë për njësitë e dukuritë e nënsistemeve të gjuhës. Në fushën e leksikut e të frazeologjisë “ballkanizmat” krijohen me rrugë disi të ndryshme nga ata të fushës së fonetikës a të gramatikës. Nuk mund të merren, për shembull, si “ballkanizma” fjalë të tilla, si *klasë, adet, xhaxha* etj., edhe pse gjenden në tri ose në më shumë gjuhë të Ballkanit. Burimi, koha dhe mënyra e shtrirjes ndër disa gjuhë të Ballkanit duhen vlerësuar si kriteret ekuivalente për të cilësuar një njësi a një dukuri si “ballkanizëm”.

b. Paralelet frazeologjike për shkak të tipologjisë gjuhësore, të krijuara në secilën gjuhë në mënyrë të pavarur; kjo përbën shtresën më të gjerë.

c. Huazimet e ndërsjellta ndërmjet gjuhëve të Ballkanit, që zakonisht gjenden në 2-3 gjuhë, pra janë më të kufizuara nga pikëpamja e areales gjuhësore.

ç. Huazimet nga gjuhë jashtëballkanike (nga turqishtja ose nga gjuhët neolatine), që janë më të shtrira ndër gjuhët ballkanike, por më të pakta si numër.

Dy shtresat e fundit janë më shumë të kushtëzuara nga faktorët jashtëgjuhësorë (gjeo-historikë, psikologjikë, mitologjikë, etno-kulturorë etj.).

Fjalori pasqyron të katër këto shtresa dhe zbulon jo vetëm përputhjet e plota e të pjesshme ndërmjet gjuhëve, por edhe dallimet, që kushtëzohen nga specifika e sistemit të secilës gjuhë, sepse gjuhët në Ballkan janë të një familjeje, por të grupeve të ndryshme (shqipe, greke, sllave, romane).

2. Makrosistemi i fjalorit përcaktohet nëpërmjet korpusit frazeologjik shqip. Lidhur me këtë korpus, për shqipen dhe për gjuhët e tjera të Ballkanit, pra për gjithë fjalorin, është zgjidhur teorikisht çështja e *identitetit* të njësie frazeologjike, çështje kyçe në teori dhe në praktikën frazeografike. Ky ka qenë problemi më i ndërlikuar e më i vështirë edhe për teorinë frazeologjike në përgjithësi, d.m.th. edhe për fjalorë të tipave të tjerë. Në fjalorin tonë ky problem zgjidhet nëpërmjet tri rrugësh:

a. Duke përcaktuar sa më prerë tiparet e qenësishme të njësie frazeologjike gjuhësore dhe tiparet e pjesshme brenda nënsistemeve të gjuhëve të veçanta. Si tipare të qenësishme kemi njohur: Strukturën sintagmore, njësimin kuptimor,

barasvlerësinë funksionale me fjalën, rrafshin e figurshëm të kuptimit, idiomatikën (formimin historik), qëndrueshmërinë, mungesën e variacionit formal, mungesën e modelit aktiv të formimit. Si tipare të pjeshme brenda nënsistemeve të gjuhëve të veçanta (të Ballkanit) kemi njohur: Tipare morfologjike (që rrjedhin nga lakimi ose nga zgjedhimi, nga numri e shquarsia tek emrat, nga mënyrat, koha, numri dhe veta te foljet); tipare sintaksore (që rrjedhin nga topika e gjymtyrëve, nga gjymtyrët fakultative, nga elementet e kontekstit, nga raportet sintagmatike); tipare leksikore (që rrjedhin nga elementet konstruktive, nga variantet sinonimike, nga raportet antonimike, nga përemrat atonë, nga parafjalët); tipare semantike (që rrjedhin nga shkalla e figurshmërisë dhe e idiomatikës, nga tema semantike, nga monosemantizmi ose polisemantizmi, nga homonimia).

b. Duke përcaktuar kufirin ndërmjet njësisë frazeologjike dhe njësave kufitare me të. Fjalori nuk e ka për detyrë të përfshijë njësi gjuhësore që kanë ndonjë tipar të njëjtë a të ngjashëm me frazeologjinë, por nuk kanë tiparet themelore të saj; kështu, fjalët e figurshme (nuk kanë strukturë sintagmore), sintagmat gramatikore (nuk janë të figurshme), shprehjet ndajfoljore (nuk janë togfjalësh), struktura me *një fjalë konkrete + një fjalë të figurshme*, togfjalëshat me përsëritje të së njëjtës fjalë, perifrazimet e kuptimit të një fjale, termat e pathjeshtë, sintagmat krahasuese, disa eufemizma, figurat letrare, frazeologjia "sintaksore" etj.

c. Duke përcaktuar kufijtë (nistor e fundor) të çdo njësie frazeologjike. Në gjuhën shqipe, p.sh., ka disa elemente dalluese të këtyre kufijve, përveç parimit të përgjithshëm të njësimi strukturor e semantik, si gjymtyra foljore në fillim, përemrat atonë, parafjalët, variacioni i gjymtyrëve fakultative etj. Në gjuhë të tjera të Ballkanit vihen re specifika të tjera, karakteristike për sistemet e tyre, që dalin në fjalor nëpërmjet barasvlerësve frazeologjikë.

3. Mikrosistemi i fjalorit ndërtohet sipas zgjidhjeve të metodës kontrastive. Specifika e çdo gjuhe në fjalor del, nëpërmjet barasvlerësve frazeologjikë, kryesisht në strukturë, sepse për vlerat semantike, funksionale e mbishtresore kërkohet një përputhje sa më e plotë. Një rol të veçantë në këtë rast luan edhe tipologjia frazeologjike. Për gjuhën shqipe kemi përcaktuar tashmë 180 "modele" strukturore, semantike e funksionale. Në disa "modele" identiteti ndërgjuhësor del më i plotë.

Përgjithësisht këto janë parime të pavarura për çdo gjuhë dhe pasqyrojnë specifikat e secilës gjuhë në strukturë, por kanë tiparet e vlerat e përbashkëta si njësi frazeologjike gjuhësore (semantike, emocionuese, etike etj.).

Në mikrostrukturë fjalori ruan maksimalisht formën e brendshme të çdo njësie frazeologjike, që përbën një nga tiparet origjinale të çdo gjuhe, veçanërisht në frazeologji. Para së gjithash në fjalor ruhet vlera leksiko-gramatikore e paraleleve frazeologjike, pavarësisht nga natyra e gjymtyrëve konstruktive, nga forma e brendshme ose nga specifikat strukturore.

Paralelet frazeologjike të plota janë më të shumta, por një pjesë e frazeologjisë mbetet për t'u dhënë në mikrostrukturën e fjalorit me mënyra e me mjete të tjera. Në pajtim me teorinë e ekuivalencës gjuhësore dhe të substitucionit, që përshkon çdo tip fjalori dygjuhësh a shumëgjuhësh, përcaktohen e zbatohen në fjalor disa përparësi, sipas këtij rendi:

a. Struktura identike (të tipit "kalk").

b. Barasvlerës frazeologjikë semantiko-funksionalë, por me temë semantike të ndryshme.

c. Barasvlerës semantiko-funksionalë të figurshëm, por nën nivelin frazeologjik.

ç. Perifrazime semantikisht të barasvlerëshme.

d. Sinonime njëfjalëshe.

Dy mjetet a mënyrat e fundit janë më pak të pëlqyeshme.

4. Ndërmjet shumë problemeve më të vogla, që zgjidhen në një fjalor të tillë, do të përmendim, së fundi, edhe dy nga më të rëndësishmit e më të vështirët:

a. *Pilisemantizmi në frazeologji*. Megjithëse kjo është një dukuri e kufizuar në fushën e frazeologjisë, vështirësitë dalin në mikrostrukturën e fjalorit, kurse zgjidhjet jepen sipas specifikës së çdo njësie. Barasvlerësit në gjuhë të ndryshme të Ballkanit zakonisht përputhen plotësisht nga ana semantike, edhe kur janë polisemantikë, por ka edhe shumë raste kur njëres njësi frazeologjike polisemantike i përgjigjen njësi të ndryshme monosemantike në gjuhë të tjera. Kjo shpjegohet me veçoritë e sistemeve semantike dhe me kushtet konkrete të formimit të idiomave në gjuhë të ndryshme, me temat semantike dhe me formën e brendshme.

b. *Variacioni në frazeologji*. Sipas kërkesave të standardizimit gjuhësor merret si pikë referimi njësia frazeologjike dominante në vargun e varianteve gramatikore të çdo njësie, por jepen si njësi të veçanta variantet leksikore brenda standardit, duke i referuar te dominantja. Kjo zgjidhje zbulon variacionin frazeologjik në gjuhë të ndryshme të Ballkanit, por tregon edhe se jo gjithnjë ka barasvlerësi të plotë në rrafshin e dominanteve.

Gjatë punës për hartimin e një fjalori frazeologjik ballkanik kanë dalë edhe shumë çështje të tjera, që lidhen me grupe të vogla njësisish ose me idioma të veçanta. Kjo është e natyrshme, sidomos në frazeografi, për shkak të specifikës së frazeologjisë gjuhësore dhe të specifikës së çdo gjuhe. Krahas veprimit të sistemit në frazeologji, mbi bazën e tipave strukturorë, semantikë e funksionalë të njësive frazeologjike, qëndron trajtimi metodikisht i çdo njësie, qoftë në korpusin shqip, qoftë në korpuset e barasvlerësve të gjuhëve të ndryshme të Ballkanit. Zgjidhje mekanike, veçanërisht në fjalorë të këtij tipi, nuk mund të ketë.

•
• •

Për një kuptim shkencor dhe për një përdorim praktik të fjalorit mendojmë se vlejné edhe këto shënime plotësuese:

1. Projekti i fjalorit, drejtimi dhe organizimi i punës hartuese në çdo hap, njësimi i trajtimit shkencor dhe hartimi i korpusit frazeologjik bazë të shqipes, me shpjegime, janë kryer nga kryetari i grupit, Jani Thomai; korpusi frazeologjik i bullgarishtes është hartuar nga Rusana Hristova; korpusi frazeologjik i greqishtes është hartuar nga Kosta Qiriazati; korpusi frazeologjik i rumanishtes është hartuar nga Ana Melonashi; korpusi frazeologjik i serbo-kroatishtes është hartuar nga Xhevat Lloshi (i cili ka ndihmuar edhe në faza të ndryshme të përgatitjes së projektit).

2. Renditja e gjuhëve është bërë alfabetikisht (*alb., bul., gr., rum., sr.-kr.*).

3. Lënia jashtë e maqedonishtes dhe trajtimi si një gjuhë i serbishtes e kroatishtes (serbo-kroatisht) janë bërë pa asnjë paragjykim. Në të dyja rastet është mbajtur parasysh që në frazeologji, si produkt historik, popullor e i lashtë, nuk ka dallime thelbësore të mjaftueshme midis maqedonishtes e bullgarishtes ose midis serbishtes e kroatishtes, duke qenë edhe të të njëjtit grup gjuhësor sllav, që doemos do të kërkonin të pasqyroheshin veçan në fjalor.

4. Renditja e frazeologjisë në korpusin shqip bëhet alfabetikisht sipas gjymtyrës së parë emërore të njësive; kur nuk ka gjymtyrë emërore, ndiqet rendi i pjesëve të tjera të ligjëratës. Bëhet përjashtim për njësi frazeologjike trigjymtyrëshe, kur

bërthama formohet nga lidhja e gjymtyrës së parë e të tretë; p.sh. tek **e bën mizën buall** bërthama është **e bën buall**, prandaj njësia vihet në rendin alfabetik të emrit **buall**.

5. Liria e komunikimit, literatura shkencore frazeologjike e frazeografike relativisht e mjaftueshme dhe bashkëpunimi i studiuesve të kësaj fushe krijuan mundësitë për formimin e grupit të punës dhe për hartimin e veprës. Hartimi i korpuseve frazeologjike për çdo gjuhë, sipas një korpusi bazë shqip, përjashton maksimalisht përrputhjet e rastit.

Është e kuptueshme që me një lëndë të tillë si frazeologjia gjuhësore, në mungesë të një modeli (të një fjalori frazeologjik shumëgjuhësh) dhe në rrethana jooptimale të shkëmbimeve shkencore, ky fjalor, duke gëzuar meritat e të parit në llojin e vet, mbart edhe të metat e natyrshme për të. Jemi të bindur që përdoruesit e tij do ta kuptojnë këtë me zemërgjerësi dhe do të kenë shpresën që pas këtij guri të parë në frazeografinë ballkanike do të vihen gurë të tjerë më të plotë, pra do të hartohen fjalorë më të mirë shkencërisht.

Hartimi dhe botimi i këtij fjalori do të ishte i vështirë për ne, nëse nuk do të ishte mbështetja financiare e Fondacionit Soros (Shoqëria e Hapur për Shqipërinë) e fituar me një aplikim të projektit më 1994, si edhe dashamirësia e mirëkuptimi i organizmave të tij që ndoqën hap pas hapi realizimin e veprës. Përveç falënderimit të singertë për ta, shpresojmë t'ua kemi shpërblyer çdo ndihmë e përkrahje nëpërmjet punës sonë të lodhshme mbi këtë vepër të vështirë.

Falënderimet u takojnë edhe dy recensuesve, Prof. Dr. Seit Mansakut dhe Prof. Dr. Emil Lafes, për vlerësimin profesional që i bënë këtij fjalori.

Jani Thomai